

Analisti, Shpend Kursani duke komentuar lirimën e imamëve, Enis Rama dhe Ekrem Avdiu, përmes një postimi në Facebook, ka thënë se komuniteti islam në Kosovë duhet ta fal shtetin e pamend, siç e ka quajtur ai.

Sipas tij, ajo çka e bën komunitetin islam në Kosovë të irritohet edhe me shume me shtetin, “është fakti që këta nuk dolën të pafajshëm nga gjykimi i gjyqtarit për mungesë të provave, por nga gjykimi i vetë prokurorit se nuk kishte prova, që fillimisht të arrestohen këta”.

Ai tha se këta dy imamë kanë folur më shumë sesa Hashim Thaçi dhe ministrat e tjerë kundër shkuarjes së qytetarëve të Kosovës në luftën e Sirisë.

Lexojeni të plotë postimin e Kursanit në facebook:

“Qitu osht puna de. Sidomos me keta dy hoxhallare qe kane fol ma shume se Hashim Thaci, Enver Hoxhaj, Bajram Rexhepi, Tracey Ann Jacobson, e krejt keta me i bo bashke, kunder perfshierjes se qytetareve te Kosoves ne Siri.

E cka e bene komunitetin islam ne Kosove te irritohet edhe me shume me shtetin eshte fakti qe keta nuk dolen te pafajshem nga gjykimi i gjyqtarit per mungese te provave, por nga gjykimi i vete prokurorit se nuk kishte prova qe fillimisht te arrestohen keta. Tmerr.

Beje thirrje komunitetin islam ne Kosove qe ta falin kete shtet pa mend, ta falin kesaj radhe duke u lutur qe t'i shtohen me shume mend ketij shteti, e ku lutja duhet te perfundoje eshte aty ku duhet filluar kundershimi i pushtetit kriminal jo per qellime fetare por per qellime te parimeve te pergjithshme per me shume drejtesi ne kete vend per te gjitha komunitetet dhe shtresat. Vetem duke luftuar kunder pushtetit qe ka kapur shtetin, ky i fundit merr me shume mend” (sic), ka shkruar Kursani në Facebook.